



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 7018 Prot

Lezhë, më 28/04 /2022

VENDIM

Nr. 42, Datë 27. 04. 2022

PËR

DISA SHITESA E NDRYSHIME NE VKB NR.157, DATË 17.11.2021
“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE PËR
SHËRBIMET PUBLIKE DHE ATO ADMINISTRATIVE, LEHTËSIRAT FISKALE,
STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË
PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

V E N D O S I :

1. Të bëjë ndryshim të pikës A.2.a.7. “Afatet e pagesës së taksës”, si më poshtë :
 - a. **Ishte** : “Për kategorinë “Biznes”, ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 31 Maj e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 31 Maj, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
 - b. **Bëhet**: “Për kategorinë “Biznes”, ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Qershor e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
2. Të bëjë ndryshim të pikës A.2.b.5. “Afatet e pagesës”, si më poshtë :
 - a. **Ishte** : “Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje këst. Afati i pagesës eshte data 31 Maj. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 31 Maj, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
 - b. **Bëhet**: “Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje këst. Afati i pagesës eshte data 30 Qershor e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
3. Të bëjë ndryshim të pikës A.2.c.4. “Mënyra e pagesës”, si më poshtë :
 - a. **Ishte** : “Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje këst. Afati i pagesës është data 31 Maj. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 31 Maj, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.

- b. **Bëhet:** “Detyrimi për Taksën mbi Truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Qershor e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.
4. Të bëjë ndryshim të pikës A.6.5. “Afati i pagesës”, nën pikat A.6.5.1 dhe A.6.5.2, si më poshtë:
- a. **Ishte** pika A.6.5.1 : Për kategorinë 1-rë, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 31 Maj të vitit fiskal, ndërsa për subjektet, që duan të identifikohen me një tabelë të re pas datës 31 Maj, detyrimi llogaritet dhe paguhet brenda 30 ditëve për periudhën nga data e deklarimit.
- b. **Bëhet :** Për kategorinë 1-rë, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit fiskal, ndërsa për subjektet, që duan të identifikohen me një tabelë të re pas datës 30 Qershor, detyrimi llogaritet dhe paguhet brenda 30 ditëve për periudhën nga data e deklarimit.
- c. **Ishte** pika A.6.5.2 : “Për kategorinë e 2-të, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 31 Maj të vitit fiskal, ndërsa për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë”.
- d. **Bëhet :** Për kategorinë e 2-të, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit fiskal, ndërsa për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë.
5. Të bëjë ndryshim të pikës B.1.3.b.5 “Afati i pagesës”, si më poshtë :
- a. **Ishte :** “Afati i pagesës për kategorinë e taksapaguesve “Biznes” është me dy këste të barabarta, brenda datës “31 Maj” dhe “30 Gusht” të vitit korent. Në rast të mos respektimit të afateve të pagesave, veprohet konform ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 31 Maj, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR.”
- b. **Bëhet:** “Afati i pagesës për kategorinë e taksapaguesve “Biznes” është me dy këste të barabarta, brenda datës “30 Qershor” dhe “30 Gusht” të vitit korent. Në rast të mos respektimit të afateve të pagesave, veprohet konform ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR”.
6. Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik 2022.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

